

Në bazë të nenit 13, paragrafi 2, nenit 16 të Ligjit për sport ("Fl. zyr. MZ", nr. 44/18), nenit 38, paragrafi 1, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18, 34/19 dhe 38/20), nenit 58, paragrafi 1, pika 4 etë Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19) dhe mendimit për pëlqimin e Ministrisë së sportit dhe të rinjve nr. 01-1050302-610/20-731-3 të datës 18.05.2020, Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . 2020 ka nxjerr

V E N D I M

për nxjerrjen e Strategjisë së zhvillimit të sportit në Komunën e Ulqinit 2020-2021

Neni 1

Nxirret Strategjia e zhvillimit të sportit në Komunën e Ulqinit për vitin 2020-2021.

Neni 2

Për zbatimin e Strategjisë do të kujdeset Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia e zhvillimit të sportit në Komunën e Ulqinit për vitin 2020-2021.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi dirën e tetë pas publikimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02 - _____
Ulqin, më ____ . ____ . 2020

KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni

Ar sy e t i m

Baza juridike:

Bazën juridike për nxjerrjen e Vendimit për miratimin e Strategjisë të zhvillimit të sportit për vitin 2020-2021, e përmbajnë dispozitat e nenit 13 dhe 16 të Ligjit për sport ("Fl. zyr. MZ", nr. 44/18), me të cilat është parashikuar që realizimin e interesit publik në sport e siguron shteti dhe komuna, për realizimin e interesit publik në sport, nxirret Strategjia e zhvillimit të sportit në nivelin lokal, ndërsa me nenin 16 të të njëjtit ligj është parashikuar që Strategjia e zhvillimit të sportit në nivelin lokal përmban nevojat afatgjata të komunitetit lokal në fushën e sportit, përparësitë thvillimore të komunës, obligimet e organizatave dhe organeve në realizimin e objektivave sportive-zhvillimore, dinamikën e realizimit të strategjisë, planet e ndërtimit, rindërtimit, adoptimit të objekteve sportie në territorin e komunës, masat për realizimin e strategjisë në nivelin lokal.

Me nenin 38, paragrafi 1, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe nenin 58, paragrafi 1, pika 4 etë Statutit të Komunës së Ulqinit, është parashikuar që Kuvendi nxjerr planet dhe programet zhvillimore për disa fusha.

Ar syet e nxjerrjes:

Komuna ka obligim që në harmoni me Ligjin për sport të sigurojë realizimin e interesit publik në sport përmes nxjerrjes së Strategjisë për zhvillimin e sportit për shkak se veprimtaria sportive, është veprimtari me interes publik, me të cilën krijohen kushtet për kryerjen e veprimtarive sportive, e të gjitha me qëllim të realizimit të interesit publik, objektivave dhe përparësive të zhvillimit të sportit në territorin e Komunës.

Në procedurën e nxjerrjes së Strategjisë është zbatuar procedura e parashikuar me ligj, në atë mënyrë që Kryetari i Komunës ka nxjerr aktvendimin për emërimin e grupit të punës për projekt Strategjinë nr. 01-310/19-1 të datës 22.08.2019, Përfundimin për konfirmimin e draftit Strategjisë nr. 01-547/20-1 të datës 24.03.2020, Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore e ka qitur në shqyrtim publik draftin e Strategjisë, më 24. 03. 2020 dhe ka hartuar raportin për realizimin e shqyrtimit publik nr. 03-191/2020 të datës 29.04.2020.

Pastaj, Ministria e sportit dhe të rinjve e Malit të Zi me parashtresën nr. 01-1050302-610/20-731-3 të datës 18.05.2020, ka dhënë mendim pozitiv për harmonizimin e draftit të Strategjisë së zhvillimit të sportit të Komunës së Ulqinit për periudhën 2020-2021 me Strategjinë e zhvillimit të sportit në Mal të Zi për periudhën 2018-2021.

Duke pasur parasysh që janë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara me ligj i propozojmë Kuvendit të Komunës që të nxjerr Vendimin për nxjerrjen e Strategjisë së zhvillimit të sportit për vitin 2020-2021.

SEKRATARIATI PËR ADMINISTRATË DHE
VEPRIMTARI SHOQËRORE

M 1000